



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 1402/7 prot

Datë 26.07.2022

**V E N D I M**  
**Nr. 718/2022**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar

Në mbledhjen e datës 26.07.2022 shqyrtoi ankesën me:

**Objekt:** Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “SARK” SHPK në procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur e thjeshtuar*”, me Nr. REF-31270-05-31-2022, me objekt: “*Blerje materiale inerte*”, me fond limit 5,911,753 lekë pa, TVSH, zhvilluar me datë 13.06.2022 nga autoriteti kontraktor, Agjencia e Shërbimeve Publike, Berat.

**Ankimues:** “SARK” SHPK.  
*Rr. “Skënderbeu”, Lagjja 8 Shkurti, Fier*

**Autoriteti Kontraktor:** Agjencia e Shërbimeve Publike Berat  
*Rr. “Baki Gjebrea”, Berat*

**Baza Ligjore:** Ligji nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*” i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “*Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*”, Neni

4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoji relatorin e çështjes, shqyrtoi ankesën e ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti kontraktor dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

## **Vëren:**

### **I**

#### *Vlerësimi paraprak*

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është nën kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga tre anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohen për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

I.4. Ankimuesi nuk ka plotësuar kushtet formale të paraqitjes së ankesës pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

### **II**

#### *Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 30.06.2022 pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është protokolluar ankesa me nr. 1402 prot., e operatorit ekonomik “SARK” SHPK për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur e thjeshtuar”, me Nr. REF-31270-05-31-2022, me objekt: “Blerje material inerte”, me fond limit 5,911,753 lekë, pa TVSH, zhvilluar me datë 13.06.2022 nga autoriteti kontraktor, Agjencia e Shërbimeve Publike Berat.

II.2. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike (SPE) më datë 22.06.2022 ka përfunduar procesi i vlerësimit të ofertave të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi, ku për vlerat pa TVSH janë rezultatet si më poshtë:

- |                |                              |
|----------------|------------------------------|
| 1. “SARK” SHPK | 5 503 600 lekë, skualifikuar |
| 2. “FLED” SHPK | 5 909 682 lekë, kualifikuar  |

II.3. Operatori ekonomik ankimues “SARK” SHPK është skualifikuar për arsyet si më poshtë vijon:

1. *“Komisioni i Vleresimit te ofertave gjate shqyrtimit dhe vleresimit te dokumentacionit per permbushjen e kriterëve per kualifikim te percaktuar ne dokumentet e tenderit, vlerëson se ofertuesi nuk ka permbushur kriteret e vecanta per kualifikim pika 2.2.3 Kapaciteti ekonomik dhe financiar pika -b-ku bilanci i vitit 2020 i kerkuar ka raport negativ ndermjet aktivitet dhe pasivit. Bilanci i vitit 2019 i cili ploteson kushtet e percaktimeve te nenit 41, germa “c “te ligjit nr.10091 date 05.03.20091. Mungon Akt Ekspertiza e Ekspertit Kontabel te Autorizuar ” kur jane ne kushtet e ligjit nr.10091 ,date 05.03.2009. “Per auditimin ligjor, organizimin e profesionit te ekspertit kontabel te regjistruar dhe te kontabilistit te miratuar “, i ndryshuar, Kreu V, neni 41, pika c per vitin 2019.*
2. *Nuk plotëson “Kriteret e veçanta te kualifikimit ‘shtojca 8’, FORMULARIN PËRMBLEDHËS TË VETËDEKLARIMIT PJESA 1 :A “Informacion në lidhje me Operatorin Ekonomik” nuk jepen te plotesuara ne perputhje me aty ku e kerkon formati si dhe ne permbajtje me te dhena per a) kodi postar ,b) Përfaqësuesi (emri) : ku pershkruhen 4 perfaqesues njekohesisht konkretisht Ar.K, AG.K , V.K, E.K.*
3. *Nuk ploteson kriterin :Kriteret e vecanta te kualifikimit “shtojca 8 ,nuk jepen te plotesuara te plota deklaratat ,te konfirmuara ose te plotesuara aty ku e kerkon formati me te dhenat per : Personi / personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, nuk është dënuar ose nuk ka qene i denuar nga nje vendim i gjykates i formes se prere per cdo veper penale të parashikuara në nenin 76/1 të LPP-së. Ne nenin 26 “ Formulari permbledhes i vetedeklarimit “, pika 1,2,3 dhe 7 te vendimit te keshillit te ministrave nr. 285 date 19.05.2021 “Per miratimi e rregullave te prokurimit publik” i ndryshuar ,parashikohet shprehimisht se: Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla. Kur autoriteti/enti kontraktor mund të marre dokumentet mbeshtetese duke u futur direkt ne nje baze te aksesueshme te dhenash shteterore ne formularin permbledhes te vetedeklarimit percaktohet edhe informacioni qe kerkohet per kete qellim, sic eshte adresa ne internet e bazes se te dhenave, cdo e dhene identifikimi dhe sipas rastit, ne deklaraten e nevojshme per dhenie pelqimi. Ne rastin konkret jane te paplotesuara rubrika perkatese, mungojne te dhenat mbi personat : Administrator, ortaku, aksioneri ose cdo person qe ka fuqi perfaqesuese, vendimmarrrese ose kontrolluese Brenda*

*Operatorit Ekonomik ,pra nuk plotesohet pika ç)-shtojca 7 DST” Kriteret e pergjithshme te perzgjedhjes /kualifikimit”.*

4. *Nuk ploteson kriterin : “ Kriteret e vecanta te kualifikimit ” 2.3.4 Me qëllim realizimin e objektit të kontratës, Operatori Ekonomik ofertues duhet të dëshmojë se ka në pronësi ose me qira: - minimalisht 2 (dy) kamiona vetëshkarkues me kapacitet mbajtës minimumi 18 (tetëmbëdhjetë) ton, - minimalisht 1 (një) eskavatorë Për mjetet që shënohen në regjistrat publikë, kur janë në pronësi duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit, leje qarkullimi, certifikata e kontrollit teknik, siguracioni i mjetit (të vlefshme) dhe certifikata e transportit të mallrave të lëshuar nga bashkia përkatëse. Ndërsa në rastin kur mjetet janë me qira, krahas dokumentacionit të mësipërm, duhet të paraqitet dhe kontrata e qirasë e noterizuar, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objektit te prokurimi. Për mjetet që nuk shënohen në regjistrat publikë, kur janë në pronësi, duhet të paraqitet kontrata e blerjes apo zhdoganimi dhe fatura tatimore përkatëse, ndërsa për mjete të marra me qira, krahas dokumentacionit të mësipërm, duhet të paraqitet dhe kontrata e qirasë e noterizuar, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekti këtij prokurimi. Ky kriter do të përmbushet nga OE me anë të Formularit Përmbledhës së Vetëdeklarimit. Dokumentacioni provues, i cili vërteton stafin teknik , do të dorëzohet vetëm nga operatori ekonomik i shpallur fitues përpara publikimi te njoftimit te fituesit dhe nisjes se afateve te ankimit. Ne kushtet kur ky kriter konsiderohet i permbushur me plotesimin me te dhenat e Kerkuara te Formularit Permbledhes te Vetedeklarimit, KVO konstaton se mungojne te dhenat dhe deklarimi I kontratës noteriale per mjetin me targa :AA 763 TY ,deklaruar si kamion veteshkarkues 18 ton ,pa deklaruar Kontraten e Qirase, Numrin, Daten e saj. Ne keto kushte kemi te bejme me nje deklarim te pa plote per “ mjetet e marra me qira ” si kerkohet ne 2.3.4 Te kriterëve te vecanta per kualifikim)”.*

II.4. Nga verifikimet e kryera, konstatohet se më datë 29.06.2022 autoriteti kontraktor ka publikuar njoftimin e fituesit në sistemin e prokurimit elektronik (SPE). Në datë 04.07.2022 në buletin nr. 90 të Agjencisë së Prokurimit Publik, është publikuar njoftimi i fituesit për procedurën e prokurimit objekt-ankimi, ku rezulton fitues operatori ekonomik “Fled” SHPK.

II.5. Referuar materialeve të fashikullit të shqyrtimit administrativ rezulton, se në datën 30.06.2022 pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është protokolluar ankesa me nr. 1402 prot. e operatorit ekonomik “SARK” SHPK lidhur me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës së tij.

II.6. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit nr. 1402/2 Prot., datë 01.07.2022, duke

referuar arsyet mbi skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “SARK” SHPK nga procedura e prokurimit objekt-ankimi.

II.7. Me shkresën e autoritetit kontraktor nr. 490/2 prot., datë 01.07.2022 me objekt “Kërkesë për korrigjim dhe plotësim” protokolluar me tonën nr. 1402/3 prot., datë 08.07.2022 drejtuar operatorit ekonomik ankimues dhe për dijeni KPP, autoriteti kontraktor shprehet se: *“Keni paraqitur pranë AK-së dhe njëkohësisht në KPP, Formularin e ankesës për objektin “Blerje material inerte” protokolluar pranë AK-së me NR. 490 prot., datë 30.06.2022 AK “Agjencia e Shërbimeve Publike” konstaton:*

*Së pari, Baza ligjore në formularin e ankesës nuk është plotësuar sipas legjislacionit në fuqi neni 111.*

*Se dyti, Ankimuesi nuk i ka bashkëlidhur ankimit dokumentin bankar që vërteton pagesën e tarifës përkatëse për ankesën. Në zbatim të ligjit 162/2022, neni 11 pika 2,3 AK “Agjencia e Shërbimeve Publike” për ta konsideruar të paraqitur ankesën tuaj kërkon korrigjimin e ankesës duke plotësuar konstatimet në respektim të afateve të korrigjimit të ankesës.”*

II.8 Me shkresën e autoritetit kontraktor nr. 507 prot., datë 06.07.2022 me objekt “Njoftim për mos pranim ankese” protokolluar me tonën nr. 1391/4 prot., datë 12.07.2022 drejtuar operatorit ekonomik ankimues dhe për dijeni KPP, autoriteti kontraktor shprehet se: *“[...] Në zbatim të ligjit 162/2022 datë 23.12.2020, neni 111 pika 2,3 AK “Agjencia e Shërbimeve Publike” për t ‘a konsideruar të paraqitur ankesën tuaj me shkresën nr. 490/1 prot., datë 01.07.2022 kemi kërkuar korrigjimin dhe plotësimin e ankesës duke plotësuar konstatimet në respektim të afateve të korrigjimit të ankesës. Në respektim të nenit 10 pika 1 të ligjit 162/2022 datë 23.12.2020 ankesa juaj nuk është plotësuar dhe është jashtë afatit ë parashikuar nga ligji dhe për këtë fakt ajo quhet e pa paraqitur.”*

II.9. Me datën 12.07.2022 përmes adresës zyrtare të KPP autoriteti kontraktor ka dërguar një e-mail me objekt “Kërkesë për sqarim” i cili u protokollua me nr. 1402/4 prot. datë 15.07.2022 duke u shprehur për operatorin ekonomik “SARK” SHPK se: *“Nga ana e institucionit tonë është njoftuar për bërjen e pagesës dhe plotësimin e të metave të ankesës nga ky operator por operatori ekonomik nuk i është përgjigjur njoftimit tonë dhe nuk ka plotësuar mangësitë dhe nuk ka bërë pagesën brenda afatit ligjor. Institucioni jonë pas kalimit të afatit 7 ditor i ka dërguar shkresën operatorit se ankesa juaj konsiderohet si e pa paraqitur dhe është e pavlefshme. Ju lutem na sqaroni dhe na informoni nëse institucioni jonë duhet të vazhdoj me lidhjen e kontratës me operatorin të shpallur fitues apo duhet të pres institucionin tuaj të dal me vendim për këtë procedurë.”*

II.10. Me memon nr. 1402/5 pot., datë 15.07.2022 me objekt “ Kërkesë për informacion në lidhje me pagesën e dosjes nr. 1402”, KPP iu drejtua Drejtorisë së Monitorimit, Shërbimeve Mbështetëse dhe Financës pranë KPP për informacion mbi pagesën e tarifës financiare të kryer nga operatori ekonomik “SARK” SHPK për procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

II.11. Me shkresën nr. 1402/6 prot, datë 26.07.2022 Drejtoria e Monitorimit, Shërbimeve Mbështetëse dhe Financës informon se: “ [...] Nga kontrolli rezulton se është gjeneruar fatura nr. A/2022/2321, datë 30.06.2022 me vlerë 29,559 lekë bashkëlidhur memos dhe protokolluar ankimi me nr. 1402 prot., datë 30.06.2022 i OE ankimues Sark ShPK. Nga verifikimi në seksionin e mandat pagesave nuk rezulton të jetë ngarkuar asnjë mandat pagesë për validim, pasqyruar si bashkëlidhur në print-sreen nga sistemi online i ankesave.”

### III

#### Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit të dosjes si edhe informacionit të autoritetit kontraktor

#### Arsyeton

III.1. Lidhur me ankesën e paraqitur nga operatorit ekonomik “SARK” SHPK për skualifikimin e ofertës së tij nga procedura e prokurimit Komisioni i Prokurimit Publik konstaton, se operatori ekonomik ankimues nuk ka kryer pagesën e tarifës financiare për ankesën e datës 30.06.2022 me nr. 1402 prot., në përputhje me përcaktimet në nenin 111 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se:

*“1. Operatori ekonomik ankimues dërgon njëkohësisht ankesën në autoritetin ose entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik.*

*Rregulla të posaçme për mënyrën e paraqitjes së ankesës përcaktohen në rregullat e prokurimit publik.*

*2. Ankesa bëhet sipas formularit përkatës, ku shënohen emri dhe adresa e ankuesit, referimi për procedurën konkrete dhe bazën ligjore, ku ankuesi pretendon për shkeljet, pagesa e tarifës së ankesës, duke e shoqëruar atë me dokumentacionin dhe provat përkatëse, për të cilat mendon se mbështesin ankimin e tij. Elementet e sipërpërmendura janë të domosdoshme për shqyrtimin e ankesës. Ankimesi është i detyruar t'i bashkëlidhë ankimit dokumentin bankar që vërteton pagesën e tarifës përkatëse për ankesën.*

*3. Nëse mungon ndonjë nga elementet e sipërpërmendura ose formulari nuk është plotësuar në mënyrën e duhur, atëherë autoriteti ose enti kontraktor duhet të vërë në dijeni ankimesin për të plotësuar formularin. Njoftimi mund të bëhet me çdo mjet të mundshëm, përfshirë edhe postën elektronike, dhe në çdo rast dokumentohet. Nëse ankesa nuk korrigjohet brenda 2 ditëve nga njoftimi, ajo vlerësohet si e paparaqitur.*

*4. Në çdo rast, paraqitja e ankesës shoqërohet me mandatpagesën e bërë pranë Komisionit të Prokurimit Publik.”*

III.1.1. Në gërmën “a” të pikës 2 të nenit 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, është parashikuar se:

*“2. Përpara lidhjes së kontratës, Komisioni i Prokurimit Publik ka të drejtë:*

*a) të refuzojë ankesën, për shkak të mosplotësimit të elementeve të domosdoshme për shqyrtimin e saj, sipas parashikimeve të nenit 111 të këtij ligji”.*

III.1.2. Me shkresën e autoritetit kontraktor nr. 490/2 prot., datë 01.07.2022 me objekt “Kërkesë për korrigjim dhe plotësim” protokolluar me tonën nr. 1402/3 prot., datë 08.07.2022 drejtuar operatorit ekonomik ankimues dhe për dijeni KPP, autoriteti kontraktor shprehet se: *“Keni paraqitur pranë AK-së dhe njëkohësisht në KPP, Formularin e ankesës për objektin “Blerje material inerte” protokolluar pranë AK-së me NR. 490 prot., datë 30.06.2022 AK “Agjencia e Shërbimeve Publike” konstaton:*

*Së pari, Baza ligjore në formularin e ankesës nuk është plotësuar sipas legjislacionit në fuqi neni 111.*

*Se dyti, Ankimuesi nuk i ka bashkëlidhur ankimit dokumentin bankar që vërteton pagesën e tarifës përkatëse për ankesën. Në zbatim të ligjit 162/2022, neni 11 pika 2,3 AK “Agjencia e Shërbimeve Publike” për ta konsideruar të paraqitur ankesën tuaj kërkon korrigjimin e ankesës duke plotësuar konstatimet në respektim të afateve të korrigjimit të ankesës.”*

III.1.3. Me shkresën e autoritetit kontraktor nr. 507 prot., datë 06.07.2022 me objekt “Njoftim për mospranim ankesë” protokolluar me tonën nr. 1391/4 prot., datë 12.07.2022 drejtuar operatorit ekonomik ankimues dhe për dijeni KPP, autoriteti kontraktor shprehet se: *“[...] Në zbatim të ligjit 162/2022 datë 23.12.2020, neni 111 pika 2,3 AK “Agjencia e Shërbimeve Publike” për t ‘a konsideruar të paraqitur ankesën tuaj me shkresën nr. 490/1 prot., datë 01.07.2022 kemi kërkuar korrigjimin dhe plotësimin e ankesës duke plotësuar konstatimet në respektim të afateve të korrigjimit të ankesës. Në respektim të nenit 10 pika 1 të ligjit 162/2022 datë 23.12.2020 ankesa juaj nuk është plotësuar dhe është jashtë afatit të parashikuar nga ligji dhe për këtë fakt ajo quhet e pa paraqitur.”*

III.1.4. Referuar pikës 2 të nenit 111 të LPP-së, Komisioni thekson, se ligjvënësi ka përcaktuar disa elemente të domosdoshme formale për paraqitjen e ankesës njëkohësisht pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor. Një prej elementeve të domosdoshme për paraqitjen e ankesës është edhe dokumenti bankar, që vërteton pagesën e tarifës përkatëse për ankesën. Ndërsa referuar pikës 3 të nenit 111 të LPP-së, Komisioni gjykon, se ligjvënësi i ka dhënë një mundësi ankimuesve, që të korrigjojnë ankesat e tyre në rast se konstatohet mungesa e një apo më shumë elementeve formale të përcaktuara në pikën 2 të nenit 111 të LPP-së. Me anë të kësaj mundësie, ligjvënësi ka dashur të përcjellë frymën, se nuk mund t’i refuzohet e drejta e ankimit subjekteve që pretendojnë se dëmtohen ose rrezikojnë të dëmtohen nga një vendimmarrje e autoritetit kontraktor në mënyrë apriori, vetëm për shkak të disa mungesave formale, të cilat mund të korrigjohen lehtësisht brenda një afati të arsyeshëm, që nuk cenon parimin e efikasitetit në procedurat e prokurimit publik. Bazuar në dispozitën e mësipërme, për të konstatuar mungesat lidhur me elementet formale të ankesës, si dhe për të vënë në dijeni ankimuesin lidhur me mungesat e konstatuara, është detyrim i autoritetit kontraktor, i cili duhet

të njoftojë menjëherë ankimuesin me çdo mjet të mundshëm, duke i lënë 2 ditë kohë për të korrigjuar elementet e domosdoshme formale të ankesës.

Referuar shkresës të mësipërme rezulton, se autoriteti kontraktor ka zbatuar përcaktimet e bëra nga ana e ligjvënësit në pikën 3 të nenit 111 të LPP-së, duke respektuar hapat proceduralë që parashikon kjo dispozitë ligjore, duke i kërkuar operatorit ekonomik ankimues “SARK” SHPK, ndreqjen e të metave të ankesës, si në rastin konkret kryerjen e pagesës së tarifës për ankesën e datës 30.06.2022 pranë autoritetit kontraktor Agjencia e Shërbimeve Publike, Berat, me përmbajtje si më sipër cituar me anë të të cilit e njofton *“për ta konsideruar të paraqitur ankesën tuaj kërkon korrigjimin e ankesës duke plotësuar konstatimet në respektim të afateve të korrigjimit të ankesës.”*

Komisioni i Prokurimit Publik thekson faktin, se përcaktimi i procedurave të caktuara në LPP dhe Rregullat e Prokurimit Publik, duke filluar nga përgatitja e ofertës, shqyrtimi i ofertave, ankimimi si dhe mundësia për të korrigjuar mangësitë lidhur me elementet e domosdoshme formale të ankesës, përfaqësojnë garanci dhe siguri juridike për palët e interesuara. Parimi i ligjshmërisë është ndër parimet kryesore të veprimtarisë së organeve të administratës publike. Gjithashtu, ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurave të prokurimit, parashikuar nga lex specialis LPP, janë ato të mosdiskriminimit, transparencës dhe barazisë. Tërësia e elementeve të mësipërme, lidhet ngushtësisht me elemente të ligjshmërisë së vendimeve të organeve të administratës publike.

Komisioni Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi faktet dhe provat bashkëlidhur dokumentacionit të dërguar nga autoriteti kontraktor thekson, se ky i fundit ka njoftuar operatorin ekonomik ankimues në formë shkresore në lidhje me korrigjimin e mangësive të konstatuara në lidhje me elementet formale të ankesës, ndër të cilët pagesës së tarifës së ankesës.

III.1.5. Në këto kushte Komisioni gjykon, se operatori ekonomik ankimues nuk është privuar nga mundësia që i jep ligji për të korrigjuar një prej elementeve formale të domosdoshme. Fakti që nuk ka korrigjuar të metat e ankesës, si në rastin konkret pagimin e tarifës së ankesës, nuk e ka privuar këtë të fundit nga një prej të drejtave më themelore në procedurat e prokurimit publik, që është e drejta e ankimit.

Referuar arsytimit, në kushtet kur operatori ekonomik ankimues nuk ka paguar tarifën financiare të ankesës si dhe ka refuzuar ndreqjen e të metave sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 111 të ligjit nr. 162/2020 *“Për prokurimin publik”*, Komisioni gjykon, se ankesa operatorit ekonomik “SARK” SHPK nuk plotëson një prej elementeve të domosdoshme për shqyrtimin e ankesës, ndaj, bazuar në gërmën “a” të pikës 2 të nenit 118 të ligjit nr. 162/2020 *“Për prokurimin publik”*, kjo ankesë duhet refuzuar.

Për sa më sipër, në mbështetje të nenit 30 dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 *“Për Prokurimin Publik”*, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”* i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr.



766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Nenit 4 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik njëzëri,

### **Vendos**

1. Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “SARK” SHPK, për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur e thjeshtuar”, me Nr. REF-31270-05-31-2022, me objekt: “Blerje materiale inerte”, me fond limit 5,911,753 lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 13.06.2022 nga autoriteti kontraktor, Agjencia e Shërbimeve Publike Berat.
  2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit të sipërcituar.
  3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
  4. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

### **KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Nënkryetar**  
**Fioorent Zguro**

**Anëtar**  
**Kreshnik Ternova**

**Kryetar**  
**Jonaid Myzyri**